



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 674 Akti

Nr. 720 Vendimi  
Tiranë, më 30.11.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Firdes Shuli</b>	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 30.11.2023, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Ollga Visi**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Neni 64, pika 1, shkronja “a” dhe neni 65, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (këtu e më poshtë referuar si “KLP”), si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Ollga Visi i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016) të gjithë prokurorët i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Në datën 15.12.2020, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit u hodh shorti për subjektet rivlerësuese, nga i cili rezultoi se procesi i rivlerësimit kalimtar për znj. Ollga Visi do të kryhet

nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Olsi Komici dhe relatore e çështjes Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan lidhur me konfliktin e interesit, si dhe zgjodhën kryesues komisionerin Olsi Komici. Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, për të cilin ajo ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

3. Komisioni, pasi zhvilloi një hetim të thelluar administrativ për subjektin e rivlerësimit Ollga Visi, vendosi në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombetar të mbyll hetimin administrativ dhe në datën 21.9.2023 e njoftoi subjektin e rivlerësimit për rezultatet e hetimit si dhe ftoi atë për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ, duke i lënë një afat 2-javor.

4. Në vijim, në datën 5.10.2023, subjekti paraqiti pranë Komisionit kërkesën drejtuar KLP-së për pension të parakohshëm dhe ndërprerje të statusit të magjistratit. Komisioni ka komunikuar me KLP-në ku, kjo e fundit, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2023, ka informuar se është administruar kërkesa nr. \*\*\*, datë 4.10.2023, e prokurores Ollga Visi, sipas së cilës është kërkuar dalja në pension të parakohshëm dhe se kërkesa i kishte kaluar për shqyrtim Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Mbledhja plenare për trajtimin e kësaj kërkesë do të mbahej në datën 20.10.2023.

5. Subjekti riinformon Komisionin në datën 18.10.2023 se i është drejtuar me kërkesë KLP-së të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, duke hequr dorë nga kërkesa për të dalë në pension të parakohshëm.

6. Në vijim, Komisioni u njoh me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2023, të KLP-së, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, për prokuroren në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, znj. Ollga Visi, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status. Sipas këtij vendimi, KLP-ja, mbështetur në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e znj. Ollga Visi, administruar në KLP me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2023, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për prokuroren Ollga Visi. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 30.11.2023.

7. Gjatë komunikimeve përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit ka informuar Komisionin se nuk e ka ankuar vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2023, të KLP-së, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, e në vijim të procesit të rivlerësimit ka informuar<sup>1</sup> gjithashtu Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në një seancë dëgjimore.

## II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

8. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

9. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se: (a) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*; (b) Subjekti i rivlerësimit znj. Ollga Visi ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen nga statusi i magjistratit gjatë procesit të rivlerësimit; (c) KLP-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2023, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistrates Ollga Visi për shkak të dorëheqjes së saj; (ç) Znj. Ollga Visi ka njoftuar se nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 20.10.2023, sipas ligjit, si dhe nuk dëshiron të marr pjesë në një seancë dëgjimore publike, në vijim të këtij procesi.

<sup>1</sup> Komunikimi elektronik i datës 8.11.2023.

10. Bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 64, pika 1, shkronja “a” përcaktohet se: “*Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ... a) jep dorëheqjen [...]*”.

11. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen dhe efektet që passjell kjo dorëheqje, si vijon: “*1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*”.

12. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, shprehet: “[...] Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

13. Subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar me vullnetin e saj të lirë në datën 8.11.2023 se: *është dakord me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2023, të KLP-së për të lënë detyrën; nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi të KLP-së; dhe nuk do të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore.*

14. Në zbatim të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit në kuadër të procesit të rivlerësimit është i rëndësishëm evidentimi i vullnetit të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për të mos vijuar këtë proces. Në këtë rast konstatojmë se vullneti i subjektit të rivlerësimit për të lënë detyrën e prokurorit që e bën atë subjekt të rivlerësimit *ex officio* është i qartë, i pavesuar dhe me pasojë ligjore aplikimin e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës që passjell ndalimin e emërimit për një periudhë 15-vjeçare si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Ollga Visi, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Ollga Visi si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
  4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 30.11.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Firdes SHULI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*